

MEDH'HEBET - PARAQITJA DHE ZHVILLIMI I TYRE*

Bashkësia e parë muslimane ka jetuar pranë Muhammedit a.s., i cili, njëkohësisht, ka qenë edhe peygamber (i dërguar i Zotit) edhe burim referimi, autoriteti. Ai i ka drejtuar besimtarët, u është përgjigjur pyetjeve të tyre dhe, kështu, i ka qetësuar e zbutur mendjet dhe zemrat e tyre. Ai ka qenë rrugë e urtësisë, e njohjes dhe shkencës. Në fillim, në praninë e tij, nuk ka patur nevojë të përcaktohen fushat e ndryshme të dijës apo të mendohet për çfarëdo një lloj specializimi brenda fushës së pastër *fetare*. Mësimi ka qenë unik, global dhe i ka përfshirë të gjitha sferat e jetës njerëzore, mirëpo Peygamberi a.s. e kishte bërë të qartë se ai ishte vetëm një njeri dhe se për sa u përket punëve të kësaj bote mund t'ia qëllonte, po mund edhe të gabonte. Për shembull, kur Peygamberi a.s. arriti në Medinë, i pa njerëzit se si i shartonin drunjtë e hurmave. U thotë atyre: *“Ndoshta do të ishte më mirë të mos e bënit këtë!”*. *Ensarët* (medinasit) pas kësaj e braktisën këtë praktikë, mirëpo prodhimi i hurmave u pakësua. Ata e lajmërojnë Peygamberin a. s. për këtë, kurse ai u përgjigjet duke u thënë: *“Unë jam njeri. Nëse ju them të bëni diçka që ka të bëjë me fenë, pranojeni atë, e nëse ju them diçka nga mendimi im personal, të keni ndërmend se unë jam njeri! Ju më së miri i njihni punët e kësaj bote”*.¹

Janë shënuar shumë situata të tjera sikur kjo e fundit, që e kanë konfirmuar statusin e Peygamberit a.s. si thesar të normave hyjnore (*furkan*) dhe, si të tillë, autoritet e referencë për gjithçka fetare, mirëpo edhe si njeri që mund të gabojë në të gjitha punët e tjera.² Këtë dallim e kanë patur të qartë *as'habët* dhe Peygamberi a.s. shpesh është konsultuar me ta kur është dashur të sjellë gjykim sipas mendimit të shumicës.³ Ky dallim i parë është shumë me rëndësi jo vetëm pse e qartëson rolin e

* Kumtesë e mbajtur në xhaminë e St. Gallenit më 7 mars 2004, me rastin e kremtimit të njëvjetorit të formimit të Forumit të Rinjve Muslimanë.

¹ *Hadith* i transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi. Dy versione të këtij hadithi i përcjellin Rafi' bin Hadij dhe Enesi r.a..

² Për sa u përket gjykimeve juridike, ku ai është dashur të gjykojë midis dy personave apo palëve, Peygamberi a.s. ka thënë: *“Unë jam vetëm njeri, kurse ju po m'i sillni përpara mosmarrëveshjet (çështjet) tuaja. Ndoshta ndokush prej jush është më elokuent (orator) në deklaratat dhe kërkesat e tij sesa ndonjë tjetër, kurse unë gjykoj në favor tuajin sipas asaj që dëgjoj prej jush. Prandaj, nëse ndodh që të sjell gjykimin për të drejtën që i takon vëllait të tij, le të mos e marrë, sepse me këtë atij i kam dhuruar vetëm një pjesë të Xhehennemit!”* (Ebu Davudi).

³ Për shembull, para betejës së Uhudit Peygamberi a.s. e lë mënjane mendimin e vet dhe e ndjek mendimin e shumicës të cilët donin të luftonin me kurejshitet jashta qytetit të Medines. Bashkësia muslimane është mundur te kodra e Uhudit, mirëpo, pas kësaj disfate, Kur'ani konfirmon se Peygamberi a.s. është dashur ta vazhdojë parimin e konsultimit (*shuras*): *“Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin*

Pejgamberit si të tillë, por edhe pse hedh dritë të re mbi nxitjen që Pejgamberi a.s. ua bënte shokëve të tij për të formuluar mendime juridike. Ashtu si ai që e bënte më të mirën që mundej sa u përket punëve të kësaj bote, po kështu edhe shokët e tij duhej ta bënin më të mirën që mundeshin si në punët e fesë ashtu edhe në formulimet juridike, gjithnjë duke i ndejtur besnikë fesë, praktikës islame dhe rrugës së drejtë. Ka patur dy faktorë kryesorë që kanë shkaktuar ndryshime të konsiderueshme brenda bashkësisë muslimane që sapo ishte themeluar në Medine. E para, tanimë nuk ishte në pyetje jetësimi i besimit intim në zemrën e individit, por çështja e organizimit të mbarë shoqërisë në emër të këtij besimi, duke dëshmuar se tanimë bashkësia ishte e aftë t'u qëndronte besnike kuptimeve dhe përshkrimeve të Porosisë kur'anore. E dyta, rritja shumë rapide e numrit të anëtarëve të bashkësisë muslimane si dhe shtrirja e vazhdueshme gjeografike e saj, përpjesëtimisht shkaktoi edhe rritjen e vështirësive. Në fillim, muslimanët është dashur ta kuptojnë Islamin në mënyrë që ta aplikonin në një mjedis tejet të njohur, pra në shoqërinë arabe të Hixhazit, mirëpo, më vonë, ata është dashur të mendojnë se si më mirë ta implementojnë Islamin në një kontekst krejt tjetërfare, me popullatë të re, me shprehje e me zakone të reja.

Gjatë pjesës së dytë të misionit të tij – dhe për shkak të këtyre këputjeve e ndryshimeve qenësore – Pejgamberi a.s. gjithnjë e më shumë mbështetej dhe i besonte aftësisë së disa shokëve, duke i bartur përgjegjësitë e tij tek ata në disa fusha ose, thjesht, duke i marrë parasysht cilësitë (kualitetet) që ishin prezente në bashkësinë e tij. Ai tanimë e kishte bërë zakon t'i punësonte e angazhonte shokët e tij sipas dijeve a zotësive të tyre: për shembull, Zejd bin Thabitin për shënimin e Kur'anit dhe Mus'ab bin Umejrin për predikimin e parë të Islamit në Jethrib (Medine), para hixhretit. Mirëpo, nevojat e bashkësisë shkonin edhe më tej se kaq: jo që kishte nevojë vetëm për njerëz që dinin të shkruanin e flisnin, por për më tepër duheshin edhe as'habë që mund t'i kuptonin parimet e Islamit mjaft sa të mund të jepnin gjykime fetare. Rrethanat e diktuan këtë zhvillim të brendshëm dhe, njëkohësisht, kjo paraqiste hapin e parë efikas drejt përgatitjes së as'habëve për ta bartur më tej mënyrën e jetesës islame, Sheriatin, pas vdekjes së Pejgamberit a.s.

Duke e zbatuar këtë metodologji praktike, Pejgamberi a. s. e dërgon Ali bin Ebi Talibin në Jemen. Ky i fundit u befasua pasi mendonte se ishte akoma shumë i ri dhe se *'nuk kishte aq njohuri për të ndarë gjykime'*. Pejgamberi a.s i përgjigjet: *"Zoti do ta drejtojë zemrën tënde dhe do ta mbajë të fortë gjuhën tënde (për ta ndjekur të vërtetën). Kur dy ndërgjyqës të ulen para teje, mos sjell vendim derisa ta dëgjosh edhe palën tjetër ashtu si e dëgjove palën e parë, sepse kjo është mënyra më e përshtatshme për të gjykuar me drejtësi!"*⁴

Krahas këtij mësimi të vazhdueshëm të kuptimeve të Shpalljeve të reja e të obligimeve të reja, Pejgamberi a. s. gjithnjë e kishte parasysht aftësinë e secilit prej as'habëve, duke i inkurajuar disa prej tyre të jepnin gjykime e të formulonin rregulla fetare (*fatva*). Ai hapur e qartë ka thënë: *"Kushdo që bën një përpjekje intelektuale (ixhtihad) dhe jep gjykim të drejtë, për këtë do të ketë dy shpërblime, ndërkaq kush*

prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ata që mbështeten!" (Alu Imran:159).

⁴ Transmeton Ebu Davudi në *Sunenin* e tij.

vepron kështu e nuk ia qëllon, ai do të ketë vetëm një shpërblim”.⁵ Para se ta dërgonte Mu’adh bin Xhebelin në Jemen, ai e pyeti: “Në bazë të çkaje do të gjykosh?”. Ai i përgjigjet: “Në bazë të Librit të Zotit (Kur’anit)”. “Çka në qoftë se nuk e gjen (përgjigjen) në të?”. “Në bazë të sunnetit të Pejgamberit të All-llahut”. “Çka në qoftë se nuk e gjen edhe aty?”. “Atëherë do të përpiqem të formoj mendimin tim personal”. Kur e merr këtë përgjigje Pejgamberi a. s., thotë: “Falë qoftë All-llahu, i Cili e ka udhëzuar të dërguarin e Pejgamberit të Vet me atë që e kënaq Pejgamberin e Vet!”.⁶

Sfidat e reja me të cilat ndeshesh shoqëria islame e Medines si dhe mjedisi burimor, e shponin bashkësinë muslimane të zhvillonte aftësi të ndryshme tek anëtarët e saj. Kështu, tanimë ishte përcaktuar orientimi i përgjithshëm: shpallja kur’anore ua kishte mësuar muslimanëve se ç’ishte *Imani*, *Islami* dhe *Ihsani*⁷; u kishte mësuar atyre thelbin e jetës, përparësitë dhe rregullat globale që ia mundësonin bashkësisë të mbetej besimtare. Të gjitha mjetet ishin në duart e tyre për ta lehtësuar implementimin sa më të shëndoshë të mësimëve islame, duke i marrë parasysh larmitë kulturore dhe gjeografike. Prandaj, inteligjenca e tyre bashkë me aftësitë që i kishin ata, është dashur të jenë në shërbim të vazhdueshëm të besimit të tyre.

Procesi i specializimit brenda mëimit islam akoma global dhe unik, ka filluar gjatë viteve të fundit të jetës së Pejgamberit a.s. Kjo dukuri shihej, edhe pse në formë embrionike, në mënyrën se si Pejgamberi a. s. i organizonte dhe delegonte përgjegjësitë e tij gjatë periudhës medinase, kur muslimanët luftuan kundër fiseve Kurajsh dhe aleatëve të tyre. Kur’ani qartë e ka drejtuar Pejgamberin a. s. për një rishikim dhe riorganizim të roleve të ndryshme të individëve brenda bashkësisë. Gjatë ekspeditës veriore për në Tebuk, është shpallur ajeti në vijim:

“Nuk është e nevojshme të dalin në luftë të gjithë besimtarët. E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t’u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet tek ata, në mënyrë që ata ta kuptojnë (e të ruhen)?” (et-Teubeh:122).

⁵ Transmeton Buhariu dhe Ebu Davudi.

⁶ Transmeton Muslimi.

⁷ Transmetohet nga Omeri r.a., i cili ka thënë: "Një ditë ishim duke ndejtur te i Dërguari i Zotit, kur u duk një njeri me rroba shumë të bardha dhe flokë shumë të zeza. Në të nuk hetoheshin shenja udhëtimi dhe askush prej nesh nuk e njihnim. U ul pranë Pejgamberit a.s. duke i mbështetur gjunjt e vet në gjunjt e tij, i vëndoi duart në kofshën e vet dhe tha: 'O Muhammed, tregomë ç'është Imani?'. Pejgamberi a.s. tha: 'Të besosh All-llahun, melekët e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e gjykimit dhe të besosh në të mirën dhe të keqen që vjen prej Zotit'. Ai i tha: 'Të vërtetën e the!'. Ne u habitëm, ky edhe e pyeste edhe ia vërtetonte atë që thonte. Pastaj i tha: 'Tregomë, ç'është Islami?'. Pejgamberi a.s. i tha: 'Të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguar i Tij, ta falësh namazin, të ndash zekatin, të agjërosh Ramazanin, të bësh haxh Qaben nëse ke mundësi'. Ai përsëri i tha: 'Të vërtetën e the!'. Pastaj i tha: 'Tregomë ç'është Ihsani?'. Pejgamberi a.s. i tha: 'T'i bësh ibadet Zotit sikur ta shohësh Atë, sepse edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty'. Ai e pyeti: 'Tregomë për orën e fundit (kijametin)!'. Pejgamberi a.s. iu përgjigj: 'Për këtë i pyeturi nuk di më shumë se pyetësi'. Ai i tha: 'Tregomë për shenjat e tij!'. Pejgamberi a.s. iu përgjigj: 'Kur robëresha t'i lindë vetes zonjushë; kur të shihen barinjët këmbëzbathur, të zhveshur e të mjerë se si garojnë në ndërtimin e godinave të mëdha'. Pastaj ai i huaji shkoi, kurse unë mbeta i habitur. Më pas Muhammedi a.s. tha: 'O Omer, a e njohe atë njeri!'. I thash: 'All-llahu dhe i Dërguari i tij e dijnë më së miri'. Më tha: 'Ky ishte Xhibrili, erdhi t'jua mësojë fenë tuaj'. (Muslimi)

Shumica e komentatorëve të Kur'anit (*mufessirun*)⁸, thonë se ky ajet ka të bëjë me ekspeditën e Tebukut, kur Shpallja e porosit Pejgamberin a. s. që disa as'habë të tij t'i mbajë pranë vetes, e të tjerët t'i dërgojë në fushatë. Kjo, për t'u siguruar vazhdimësia e përhapjes së diturive islame nëpërmjet Shpalljes dhe thënieve të Pejgamberit a. s. Nga ky ajet, dijetarët (*ulemaja*) kanë nxjerrë disa mësimë të rëndësishme, përfshirë edhe idenë për ndarjen e mundshme, e ndonjëherë të domosdoshme, të funksioneve brenda bashkësisë muslimane në dritën e obligimeve personale apo kolektive (*farzi ajn* ose *kifajeh*).⁹

Me kalimin e kohës ky proces do të theksohet edhe më tej me paraqitjen e fushave më specifike të diturisë islame. Për shembull, fusha e recitimit dhe kuptimit të Kur'anit, fusha e njohjes dhe shënimit të thënieve dhe sjelljeve të Pejgamberit a.s., gjykimi mes njerëzve duke u mbështetur në burimet islame, dhënia e përgjigjeve juridike (*fetva*) e kështu me radhë. Vdekja e Pejgamberit a. s. e intensifikon nevojën që bashkësia t'i tubojë të gjithë as'habët e mbetur gjallë për ta marrë mbi vete barrën e sfidës së vazhdimit të misionit të tij. As'habët më të aftë kanë kontribuar në ruajtjen e përmbajtjes, kuptimit, intensitetit dhe të domethënieve sociale, politike dhe ekonomike të mësimëve të Zotit e të Pejgamberit të Tij. Edhe në mungesën e Pejgamberit a. s. kishin mbetur të njëjtat pyetje: Si të ruhet besimi? Si të zbatohet feja? Si të arrihet përsosuria (*ihsani*)? Me fjalë të tjera, *si të mbetesh besimtar?*

Zgjerimi i bashkësisë islame dhe ndryshimet në kontekstin social, kulturor dhe historik kanë qenë, përgjithësisht, njëri prej dy faktorëve kryesorë që kanë çuar deri te formimi i domosdoshëm i shkencave të veçanta islame. Faktori tjetër mbështetet në esencën e dy fushave fundamentale islame dhe në mënyrën se si ato i janë prezentuar mendjes së besimtarit. Tanimë e kemi përmendur *hadithin e ihsanit* dhe leximin e vetëm i cili tregon tri (më vonë katër) fusha të veçanta që do të korrespondojnë me shkencat specifike islame: *imani* dhe elementet e tij do të bëhen *ilmul-akideh* (shkenca e besimit), *islami* do të bëhet *fikhul-ibadat* (pjesa e parë e të cilit quhet *el-fikhul-islamij*, shkenca e së drejtës islame), kurse *ihsani* sipas kuptimit të tij të dyfishtë të lidhur me aktivitetin njerëzor do të bëhet në aspektin e tij individual dhe intim *ilmul-ahlak* (*tasavvufi*, sufizmi-misticizmi është i lidhur me këtë fushë) e në aspektin social, komercial dhe juridik *fikhul-mu'amelat* (pjesa e dytë e *el-fikhul-islamij*). Të gjitha këto studime, natyrisht, janë peshuar, shqyrtuar dhe përpunuar në dritën e Kur'anit dhe të Sunnetit të Pejgamberit a. s., të cilët, si të tillë, kanë krijuar dy fusha të reja të diturisë: *ulumul-Kur'an* (shkencat mbi Kur'anin) dhe *ulumul-hadith* (shkencat mbi hadithin).

Siç kemi thënë, gjatë kohës sa ishte gjallë Muhammedi a. s., gjërat ishin të qarta e mësimet unike e globale. Gjatë kohës së *hulefa'ur-rashidunëve* (halifëve të drejtë, ndërmjet viteve 632-661 e. r.),¹⁰ as'habët e ngushtë dhe bashkësia islame e ruanin në

⁸ Shih, për shembull, Taberiu, Kurtubiu dhe Ibni Kethiri.

⁹ Rregulli është, këtu, që edhe detyra e luftimit gjatë luftës po edhe e përfitimit të dijes-studimi, konsiderohen obligime kolektive (*farzi kifajeh*) në kuptimin që nëse një grup i një bashkësie të caktuar i kryen këto detyra, obligimi bjen nga pjesa tjetër e bashkësisë.

¹⁰ Katër shokët më të ngushtë të Pejgamberit a.s. dhe pasardhësit e tij si kryetarë të shtetit islam të Medines kanë qenë: Ebu Bekri (632-634), Omeri (634-644), Osmani (644-656) dhe Aliu (656-661) r.a.

zemrat dhe mendjet e tyre kuptimin e Shpalljes dhe mësimet e Pejgamberit a. s. Njëra prej nevojave të para që u paraqit pas luftës që u zhvillua kundër fiseve jugore arabe të cilat kishin refuzuar pagimin e zekatit si dhe vdekja e më tepër se 70 *hafizëve* (as'habëve që e dinin përmendsh tërë tekstin e Kur'anit), ishte përpilimi i një kopjeje të tërë Shpalljes sipas radhitjes definitive të saj, që të shërbente si një burim i mundshëm referimi. Deri në këtë moment, afërsia e këtyre as'habëve me misionin e Pejgamberit a. s., si në zemër ashtu edhe në kohë, një lloj kodifikimi të tillë e bënte të panevojshëm. Vendimet merreshin në formë të përbashkët në dritën e kuptimit të thellë të tyre që e kishin lidhur me Shpalljen dhe domethënien e saj për jetën individuale dhe komunale. Referenca ishte e njohur mirë, kështu që Ebu Bekri tha: “Unë jam zgjedhur si udhëheqës i juaji, mirëpo unë nuk jam më i miri prej jush. Në qoftë se i përmbahem së drejtës, ndihmomëni! Po nëse lakoj, drejtomëni!”. Ishte e qartë se kishte vetëm dy parametra për atë se ç'është e drejtë dhe e padrejtë në mendjen e Ebu Bekrit dhe në mendjet e tërë bashkësisë, Kur'ani dhe Sunneti, pasi të gjithë e kuptonin dhe e zbatonin thënien e Pejgamberit a.s. : “Nuk i tregohet dëgjueshmëri krijesës, nëse me të i tregohet padëgjueshmëri Krijuesit!”.¹¹

Gjatë kësaj periudhe, takimet konsultative ishin të shpeshta dhe shumica e vendimeve juridike dhe politike merreshin bashkërisht dhe shumë shpesh të mbështetura në konsenzusin e as'habëve. Këta as'habë kanë ngurruar të sjellin rregulla juridike (*fetva*) në mënyrë individuale dhe janë përpjekur që, kur është dashur, ta dërgojnë pyetësin te ndonjë as'hab tjetër të cilin e kanë konsideruar më të kualifikuar. Në thelb, ata i janë përmbytur ngushtë kuptimit literal të Shpalljes lidhur me pyetjen në fjalë¹² dhe i kanë ikur theksimit të tepruar të *haditheve* për të mos e cituar gabimisht Pejgamberin a. s.¹³ dhe, mbi të gjitha, përpjekjet e tyre i kanë përqëndruar në studimin e Kur'anit. Tek e fundit, ky ka qenë edhe rekomandim i Omerit r. a. si para ashtu edhe gjatë sundimit të tij si halif.

Kah fundi i sundimit të Aliut r. a., bashkësia muslimane u ndesh me kohën më të vështirë që nga vdekja e Pejgamberit a. s. Plasën konfliktet e para për pushtet, të cilat çuan drejt një trazire të madhe shoqërore dhe lindjes së ndarjeve brenda bashkësisë. Pas vdekjes së Aliut r. a. dhe me ardhjen në pushtet të Muavije bin Ebi Sufjanit, problemet u shtuan dhe, së këndejmi, ndikuan në implementimin e vërtetë të mësimëve islame. Gjatë periudhës së emevitëve (661-750 e. r.), të nisur nga Muavija, së paku katër dukuri devijimi shkaktuan përmbledhjen në një vend të *haditheve* krahas paraqitjes së studimeve specifike të burimeve islame nga ana e *ulemasë*. Dukuria e parë ishte futja e një praktike të re në punët e shtetit islam, e ndikuar nga kulturat persiane, bizantine dhe indiane: në vitin 679 e. r., për shembull, posti i halifit u shndërrua në një mbretëri të trashëguar, kurse arka e shtetit (*bejtul-mal*) u kthye në

¹¹ Transmeton Buhariu.

¹² Shumë herët janë paraqitur dy tendenca ndër as'habët si rezultat i ndikimit të dy figurave eminente të kësaj periudhe: Abdullah bin Omeri, i cili përgjithësisht u ka ikur interpretimeve personale dhe Abdullah bin Mes'udi, i cili gjerësisht e ka përdorur mendimin personal në qoftë se nuk ka mund të gjejë përgjigje ose rregull të qartë në Kur'an dhe në Sunnet. Më vonë këto dy qëndrime do t'i hasim ndër dijetarët (*ulema'*) dhe shkollat e mendimit (*medhahib*): ata janë të njohur me emrat *ehlul-hadith* (të vendosur në Medine) dhe *ehlur-re'j* (të vendosur në Kufë të Irakut).

¹³ Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kushdo që flet rrejshëm në emrin tim, ai do ta gjejë veten në Xhehennem!” (Transmetojnë Buhariu dhe Ebu Davudi).

pronë private të halifëve dhe familjeve të tyre. Në këtë mënyrë, u zhduk parimi i këshillimit (*shura*) dhe i participimit shoqëror, kurse reaktioni i parë i *ulemasë*, e cila refuzoi t'u nënshtrohej verbërisht dhe qyqarisht dëshirave dhe ambicieve personale të mbretërve të rinj, ishte mbledhja dhe kompilimi i rregullave juridike, që do të bëhet element i shkencës së të drejtës islame (*fikhut*).

Dukuria e dytë ka qenë shpërndarja e *ulemasë*: disa e kishin braktisur prishjen dhe falimentimin e kryeqytetit apo të qendrave të tjera politike, të tjerët thjeshtë ishin shpërngulur në vise të ndryshme, kështu që u bë e pamundshme që *ulemaja* të tubohej në një vend për të formuluar rregulla juridike të mbështetura në konsenzusin e tyre (*ixhma*). Të shkapërderdhur, të ballafaquar me larmi gjeografike, kulturore dhe shoqërore si dhe të vetmuar në kërkimet e tyre për vendime të përshtatshme (*ixhtihad*), dijetarët kanë theksuar dhe formuar, shpesh pa dëshirë, shumë shkolla mendimesh me anë të studentëve që u rrinin për qark. Kështu ka qenë rasti me Ebu Hanifen dhe Theuriun në Kufë, me Malikun në Medine, me Euza'iun në Siri dhe me el-Lejthiun në Egjipt.

Dukuria e tretë ka qenë fenomeni i ri i trillimit të *haditheve* si rezultat i nevojës së shtuar për informacione, por edhe si rezultat i interesave politike. Kjo periudhë është dëshmitare jo vetëm e studimeve të thella në fushën e fesë, por edhe e dukurisë, për herë të parë, së përshkrimit të thënieve dhe sjelljeve të rrejshme ndaj personalitetit të Pejgamberit a. s. Kjo ishte koha e problemeve dhe trazirave kur parti e palë të ndryshme përpiqeshin t'i arsyetonin pozicionet e tyre duke u thirrë në hadithe të trilluara. Reagimi i dijetarëve me këtë rast ishte përmbledhja dhe tubimi i haditheve për të cilat ishin të sigurtë se ishin të vërtetë (*sahih*), me çka lindi shkenca e kriticizmit të hadithit.

Dukuria e fundit – e cila njëkohësisht ka qenë edhe shkak edhe pasojë e tri dukurive të mëparshme – kanë qenë zënkat dhe kundërshtimet e tendencave dhe partive të ndryshme brendapërbrenda bashkësisë muslimane. Dy përçarjet më të mëdha kanë ndodhur në betejën e Siffinit (657), e cila shkaktoi paraqitjen e grupit të ashtuquajtur *Havarixh / Harixhijje* (secesionistët), dhe beteja e Kerbelasë (680, në të cilën vritet Husejni, i biri i hz. Aliut), e cila shkaktoi reagimin e ithtarëve të Aliut dhe përforcimin e grupit *Shi'it*. Gjatë kësaj periudhe qindvjeçare kanë ndodhur edhe incidente të tjera më të vogla të cilat e kanë shtuar tensionin dhe trazirat dhe, nga ana tjetër, kanë nxjerrë në pah nevojën për kodifikimin e rregullave që kanë të bëjnë me Islamin, sidomos në fushën juridike.

Dy dukuritë kryesore që i përmendëm – shpërndarja e *ulemasë* dhe trillimi i *haditheve* – kanë shkaktuar një ndryshim serioz në përcjelljen e diturive islame. Muslimanët, për herë të parë kanë përjetuar shtimin e mendimeve të kualifikuara dhe autoritative; ato jo vetëm që kanë qenë të ndryshme, por ndonjëherë, në aspektin e çështjeve dytësore, kanë qenë tërësisht të kundërta. Madje edhe qasja ndaj prolemeve dhe situatave ka qenë tërësisht e ndryshme: në Medine, duke e ndjekur shembullin e Abdullah Ibni Omerit, *ulemaja* është kufizuar me leximin e ngushtë të Kur'anit dhe Sunnetit, duke u ikur interpretimeve individuale (këta janë quajtur *ehlul-hadith*), kurse në Irak, Kufë - të njohur si *ehlur-re'j* – dijetarët e kanë ndjekur rrugën e Abdullah ibni Mes'udit duke e përdorur rezonimin, analogjinë dhe duke mos iu shmangur përfytyrimit dhe spekulimit- teoretizimit të problemeve dhe situatave burimore.

Historia dhe dallimet në kontekstin shoqëroro-politik mund t'i shpjegojnë këto përçarje, mirëpo po kaq është e qartë se këto dallime – të cilat akoma janë konsideruar se bëjnë pjesë brenda zonës të së lejuarës – është dashur të rregullohen në mënyrë që mendimet të mund të cilësohen si të vërteta apo të pavërteta nga aspekti juridik. Periudha e emevitëve i vëndoi shenjat e para në këtë rrugë, e cila i drejtoi studimet dhe kërkimet e dijetarëve dhe nga e cila do të paraqiten degë të ndryshme të shkencave islame.

Gjatë dy shekujve të parë të sundimit të dinastisë abbasite (përafërsisht 750-1258) shumë shpejt kanë ndodhur disa ngjarje, ndaj mund të thuhet se gjatë kësaj kohe janë formuar dhe determinuar fushat e veçanta të shkencave islame: problemet shoqërore dhe politike prodhuan shqetësimin dhe rrezikun që bashkësia muslimane të bëhej gjë e harruar në aspektin e kërkesave të fesë, që ajo të mund t'i tradhtonte burimet e saj dhe, përfundimisht, gjithë kjo mund të çonte deri te shkatërrimi i tërësishtëm i saj. Qindvjeçari i parë i kësaj periudhe njihet si koha e *imamëve të mëdhenj* (750-850): kjo ishte koha e lulëzimit të shkencave islame, sidomos e atyre të së drejtës islame (*fikh*) dhe e kritikizmit të *hadithit*. Halifët e parë abbasij kanë treguar respekt të veçantë ndaj së drejtës islame dhe ndaj dijetarëve të saj. Shumë halifë, si Harun er-Rashidi (ka sunduar 786-809) ose el-Mansuri (ka sunduar 754-775), edhe vetë kanë qenë dijetarë ose kanë angazhuar dijetarë për të bërë tubimin dhe përpilimin e librave autoritative të Sunnetit. Gjatë kësaj kohe gjallëronte një liri e konsiderueshme e mendimit dhe gjerë e gjatë hilafetit, në shumë qendra të shumta mendimi, studimi dhe diskutimi zhvilloheshin me gjallërinë dhe prodhimitarinë më të madhe. Përpos kësaj, në këtë kohë është paraqitur një numër i konsiderueshëm i dijetarëve të mëdhenj, të cilët jo vetëm që i kanë mësuar të tjerët por edhe vetë ata kanë qenë angazhuar në diskutime të thella reciproke. Kësisoj, tanimë ekzistonin të gjitha elementet që e shpjegojnë vitalitetin intelektual të kësaj kohe.


U formua një numër i madh i shkollave të mendimeve rreth dijetarëve të njohur, siç ishin Ebu Hanifja (703-767) në Kufë, el-Euzaiu (708-774) në Siri, Maliku (717-801) në Medine, Zejdi (700-740) në Kufë dhe Vasit, el-Lejthiu (716-791) në Egjipt, eth-Theuriu (719-777) në Kufë, Shafiu (769-820) në Bagdad dhe Kajro, Ibni Hanbeli (778-855) në Bagdad, Ebu Davudi (815-883) në Kufë ose et-Taberiu (839-923) në Egjipt dhe Taberistan. Të gjithë këta dijetarë përbënin instrumente përmes të cilëve është bërë një progres i dukshëm në studimet islame e veçanërisht në fushën e së drejtës islame (*fikh*). Secili prej tyre, gjatë jetës së vet, ka dhënë një kontribut të veçantë dhe e ka ndihmuar zhvillimin e drejtimit pozitiv në të kuptuarit e burimeve islame. Secili prej tyre konsiderohet – duam apo nuk duam – si themelues i një *medh'hebi* (shkollë mendimi): disa prej tyre janë zhdukur gjatë historisë, kurse shkollat e tjera sot janë të njohura gjetiu në botën muslimane (sidomos *medh'hebi* hanefij, malikij, shafi'ij, hanbelij dhe zejdi).

Përfundimisht vlen të theksohet se paraqitja e shkollave juridike (*medh'hebeve*) ka qenë një dukuri e determinuar nga vetë burimet e Islamit si dhe nga rrethanat e ndryshme gjeografike, shoqërore e politike. Janë paraqitur si rrjedhojë e përgjigjes ndaj këtyre rrethanave e kushteve të reja të kohës. Edhe pse të ndryshme prej njëra-tjetrës, këto shkolla kanë luajtur rolin e vet në ngritjen e shoqërisë dhe ummetit islam në piedestalin më të lartë të kulturës dhe qytetërimit.

Shtojcë – I: FAZAT E ZHVILLIMIT TË *FIKHUT*

PEJGAMBERIA	(609 – 632)	= 23 vjet
AS‘HABËT	(632 – 661)	= 29 vjet
NDËRTIMI	(661 – 750)	= 89 vjet
LULËZIMI	(750 – 960)	= 210 vjet
KONSOLIDIMI (PËRFORCIMI)	(960 – 1258)	= 298 vjet
NGECJA DHE RËNIA	(1258 -1870)	= 612 vjet
PERIUDHA BASHKËKOHORE: RINGJALLJA E <i>IXHTIHADIT</i> (1870 - /)		= 130 vjet

Shtojcë – II: PERIUDHA E JURISTËVE TË PARË



Burimet:

1. *KUR'ANI- Përkthim me komentim në gjuhën shqipe*, përkthim i Sherif Ahmetit.
2. *Kutubi sitte* (Gjashtë përmbledhjet e haditheve).
3. Hayrettin Karaman, *Islam Hukuku Tarihi*, Stamboll, 1997.
4. Tariq Ramadan, *To Be A European Muslim*, bot. The Islamic Foundation, Leicester – Angli, 1999.
5. Muhammed Hamidullah, *Uvod u Islam*.